



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

## PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2020

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

## U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njërën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë **NUK** është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara **për koncept** (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

**Me fat!**




\* A 1 0 7 1 0 7 1 \*



# FAQE E ZBRAZËT

## KONSUMIMI I UJIT

Trendi i rritjes së nevojave për ujë, madje edhe në vendin tonë, theksohet edhe sot. Në 100 vitet e fundit, harxhimi i ujit është rritur tetëfish. Posaçërisht është shqetësuese rrethana që është një trend evident i zvogëlimit të rezervave të disponueshme të ujit për një banor në të gjitha kontinentet. Ky trend nuk është pasojë e zvogëlimit të sasisë së burimeve të ujit sepse ajo sasi është konstante, por është pasojë e rritjes së numrit të popullsisë, ndryshimeve klimatike, qyteteve të mëdha dhe ndotjes gjithnjë e më të madhe, veçanërisht të ujit sipërfaqësor. Sipas parashikimeve, deri në vitin 2025 të paktën 3.5 miliardë njerëz në botë do të ndiejnë mungesën e ujit. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH), rreth 400 milion njerëz në vendet në zhvillim, vuajnë nga sëmundjet të cilat janë pasojë e përdorimit të ujit të pijshëm i cili nuk është i pastër sa duhet (nga këto sëmundje



çdo ditë vdesin 30 000 njerëz). Ujë të pastër ka gjithnjë e më pak dhe ajo është gjithnjë e më e shtrenjtë. Dihet se për të jetuar dhe zhvilluar veprimtari ekonomike njeriut në vendet e banuara sot i nevojiten 200-500 l të ujit të pijshëm/për një banor/në ditë. Amvisëritë konsumojnë më së pakti, pastaj industria, dhe më së shumti bujqësia. Sidoqoftë, në disa vende të zhvilluara, ku industria është shumë e zhvilluar dhe nëpër

vendbanime, harxhimi i ujit i tejkalon 500 l/për një banor në ditë (Birmingeni 655, Moska 600, Oslo 593). Nga ana tjetër, në disa vende në zhvillim, një person, mesatarisht, harxhon 10 l ujë në ditë. Kjo është e njëjta sasi që harxhojmë për shpëlarjen e wc-së vetëm me një trysni në shkarkuesen e ujit. Një amvisëri mesatare evropiane konsumon rreth 180 l/për një banor/në ditë.

### Sasia e ujit e nevojshme për prodhim:

1 litër birrë – 40 l  
1 kg patate – 500 l  
khinsat – 8000 l

1 kg oriz – 1 900 l  
1 kg mish zogu të pulës – 3 500 l  
1 kg mish lope – 100 000 l

(Përshtatur sipas <http://www.znanje.org/i/i10/10iv01/10iv0111/potrosnja%20vode.htm>)

Tabela 22. – Konsumi mesatar i ujit për person në ditë

Konsumatori	Q // ditë
Personi në ndërtesën individuale të banimit	75-150
Personi në ndërtesat e mëdha të banimit	50-120
Personi në hotel	250-400
Ndërtesat administrative	12-15
Mesatarisht një banor në vendet e vogla	60-100
Mesatarisht një banor në qytete	100-150
Mesatarisht një banor në qytetet e mëdha	150-300
Spitalet sipas të sëmurit	250-400

Kinematë dhe teatrot sipas vizitorit	2-4
Banjat dhe vendet klimatike për person	100-150

*(Përgatitur sipas tekstit shkollor për vitin e 4-të të profesionit të ndërtimtarisë teknik i ndërtimtarisë për ndërtimet e larta, Instalimet shtëpiake – Vesna Stanojeviq, Milena Zoroje)*

- 1.** Shkruani dy shkaqe të cilat sjellin deri te zvogëlimi i burimeve të ujit në të gjitha kontinentet.

.....

1 pikë

- 2.** Në bazë të tekstit dhe diagramit konstato sa është harxhimi i ujit me përqindje në lëmin e industrisë.

.....

1 pikë

- 3.** Për të cilin prodhim në fushën e bujqësisë është e nevojshme sasia më e madhe e ujit?

.....

1 pikë

- 4.** Për shkak të përdorimit të ujit për pije i cili nuk është i pastër sa duhet, sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetit, gjatë një dite vdesin:

1. 3,5 miliardë njerëz
2. 400 milionë njerëz
3. 30 000 njerëz.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

- 5.** Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse i pasaktë, rretho P dhe argumento përgjigjen.

KONSTATATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Një person, gjatë një dite, mesatarisht harxhon më shumë ujë në vendet në zhvillim sesa në vendet e zhvilluara.	S      P	

1 pikë

6.

Në bazë të të dhënave në tabelë shkruaj sa duhen mesatarisht ujë në ditë për kujdesin e duhur për të sëmurit në spital.

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin, zhvillo detyrat 7, 8, 9, 10 dhe 11.

### HISTORIA E SHKURTËR E FANELLAVE DHE MASKAVE

Ekzistojnë dëshmi të dukshme për ekzistimin e sportit dhe teatrit në qytetërimet e para, në realitet, në variantet dukshëm të ndryshuara dhe me funksione të ndryshme shoqërore... Vlen të përmendet se Lojërat Olimpikë, si dhe garat tjera sportive kanë pasur, të thuash, karakter shtetëror, derisa personat e parë tragjik kishin garuar ekskluzivisht në nivel të qytetit – sporti gjithmonë ka qenë dhe do të mbetet më i popullarizuar sesa teatri. Siç u përmend, të dy lojërat kishin një prapavijë religjioze – Olimpiada iu kushtua Zeusit, Lojërat Pythiane Apolonit, Festivali i Dionisit (brenda të cilit ka lindur edhe tragjedia) Dionisit.

Dallimi i vetëm i vërtetë në mes të sportit dhe teatrit qëndron në faktin se loja mbi dërrasa ka skenarin e paracaktuar, derisa loja në terren (të paktën zyrtarisht) nuk ka.

Për nevojat e dramave *reale* historike, si dhe takimin e parë, dhe të vërtetë të teatrit dhe sportit zhvendosemi në hapësirë dhe kohë në Mbretërinë Romake, saktësisht në arenat e gladiatorëve, të cilat ishin shumë më tepër sesa një luftë e përgjakshme deri në vdekje. Për më tepër, *luftërat deri në vdekje*, në kundërshtim me atë që keni parë në filmin *Gladiator*, ishin ngjarje të rralla.

Sidoqoftë, ajo që thuhet edhe më rrallë është se këto luftëra shpesh ishin më shumë një spektakël teatral sesa një përleshje e vërtetë... Këtë e dinte edhe vetë publiku të cilit nuk i pengonte fare që të kënaqej me ato *shfaqje*.

Nga ana tjetër e medaljes, sot ka shfaqje të luftimeve të cilat vetëm në dukje ngjajnë në ngjarje sportive – mundja amerikane, e njohur në popull si keçerët. Në Meksikë ndërkaq keçerët, si grekët e lashtë, bartin maskat, të cilat mund të përzihen lehtë me reliktet fetare. Pamja e maskave është ajo që e karakterizon personazhin (nga demoni dhe djalli deri te shenjtë dhe superhero) dhe pikërisht këtyre personazheve publiku u brohorit, dhe jo aq njerëzve nën maska. Dhe si superheronjtë e vërtetë, mundësit mexikan shpesh e fshehin identitetin e tyre të vërtetë nga publiku...

Por, përveç shfaqjeve të tilla profesionale, ka një numër në rritje të shfaqjeve me rezultate të pasigurta, ku aktorët marrin vetëm rregullat brenda të cilave duhet të luajnë, por edhe vetë aktorët nuk e dinë rezultatin përfundimtar. Një nga shembujt e shfaqjeve të tilla të improvizuara është edhe *Ju lutem vazhdoni*, një përpunim modern i *Hamletit*. Në të, tre aktorë profesionistë luajnë Hamletin, Ofelinë dhe Gertrudën të cilët duhet para gjykatësve të vërtetë, ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe avokatëve ta dëshmojnë pafajësinë e tyre ose fajin e tjetrit. Në këtë realizim, publiku, përveç rolit metaforik të gjykatësit, është edhe porotë e mirëfilltë në këtë shfaqje.

Është e qartë se kufiri në mes të teatrit dhe sportit është më i vështirë për t'u gjetur nga se menduam fillimisht. Arsyeja për këtë ndoshta qëndron në mundësinë që format e tyre më të mira, të dy llojet e lojërave prodhojnë si një katarsis, ashtu edhe një ndjenjë

lidhjeje dhe afërsie me, përndryshe, anëtarët e panjohur të publikut. Në atë emër të asaj:  
Ale, ale, ale!

(<https://www.casopiskus.rs/kratka-istorija-dresova-i-maski/>)

**7.** Nëse pohimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P.

Në Greqinë e Lashtë shfaqjet sportive dhe teatrore kishin prapavijë fetare.	S	P
Lojërat sportive shkaktojnë një katarsis tek shikuesit.	S	P
Në shfaqjet tradicionale aktorët nuk e dinë rezultatin përfundimtar.	S	P

1 pikë

**8.** Cili është ndryshimi i vetëm i vërtetë në mes të teatrit dhe sportit?

.....  
.....

1 pikë

**9.** Çfarë e bën moderne shfaqjen *Ju lutem vazhdoni?*

.....  
.....

2 pikë

**10.** Duke u bazuar në tekst, shpjegoje pohimin se mundja amerikane (në popull e njohur si keçerët) nuk është vetëm ngjarje sportive.

.....  
.....

2 pikë

**11.** Rretho numrin para stilit funksional me të cilin është shkruar teksti dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. administrativ
2. letrar
3. publicistik

1 pikë

- 12.** S'linda për urrejtje, por për dashuri.  
Me hike unë n'luftë!... Shpejt, Jonathas,  
Këndo, hyjneshë, mëninë e Akil Pelidit

**Pranë titullit të veprës letrare, nga vargu i dhënë, përshkruaje citatin e njohur. Kujdes, një vepër është e tepërt.**

1. *Juda Makabe* .....
2. *Antigona* .....
3. *Iliada* .....
4. *Çeta e Profetëve* .....

2 pikë

**Në bazë të fragmentit të dhënë, si dhe veprës në tërësi, zhvillo detyrat 13, 14, 15 dhe 16.**

Cila ishte kjo grua që si ndonjë fantazmë, futej tinëz në mes të natës në dhomën e Bardhës?

Sapo u ngrit më këmbë mbi dysHEME, iu afrua Bardhës që të sigurohej se po flinte; pastaj pa derën dhe pa se ishte mbyllur brenda. Iu afrua Bardhës lehtë-lehtë e pa e ndier. Fytyra e gruas së re vetëtinte nga bukuria; një hije e lehtë melankolie u jepte tipareve të saj diçka poetike dhe hyjnore... Por vështrimi i egër i shtrigës nuk u ndal në atë fytyrë të bukur, sytë e saj të ndezur flakë, si sytë e hienës, kërkonin kraharorin e Bardhës, atë kraharor të bardhë si alabastri, gjysmë të zbuluar e që një frymëmarrje e njëllajtë e ngrinte lehtë e me ngadalë.

Ajo nxori më në fund pistoletën e fshehur në përparëse, mbështeti tytën në zemrën e viktimës dhe hoqi këmbëzën. Arma u shkreh dhe bëri një zhurmë të mbytur. Dhoma u mbush me tym dhe me një erë squfuri. Kjo dhomë që kishte qenë dëshmitare e dhembjeve të një engjellusheje, u shndërrua në një shpellë skëterre, në një limer krimi e vrasjeje.

Bardha nuk bëri kurrfarë lëvizjeje, nuk lëshoi asnjë klithmë, ajo mbajti atë pozë që kishte marrë tek e kishte zënë gjumi; vetëm hapi sytë dhe për një çast i hodhi një vështrim të mekur xhelatit të vet.

Plumbi e kishte përshkruar tejprtej atë zemër të thjeshtë e të zjarrtë.

- E lava me gjakun e saj gabimin e tim biri, - murmuriti vrasësja e neveritshme, duke lëshuar armën fare pranë afër divanit ku po dergjej viktimë. Dhe me shpejtësinë e shkathtësinë e tigrin, u fut në vrimën nga kishte ardhur, lëshoi kapanxhën e u zhduk në errësirën e bodrumit.

- 13.** Shkruaje titullin e veprës nga e cila është shkëputur ky fragment, si dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

.....

1 pikë

**14.** Cila është tema kryesore në këtë fragment?

.....

1 pikë

**15.** Kush e kreu aktin e vrasjes së Bardhës?

.....

1 pikë

**16.** A) Përshkruaje paragrafin rrëfyes nga fragmenti.

.....  
.....

1 pikë

B) Përshkruaje paragrafin përshkrues nga fragmenti.

.....  
.....

1 pikë

**17.** *I bëhet arra gogël është:*

1. zhargonizëm
2. frazeologjizëm
3. neologjizëm

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**18.** A) Skruaj drejtë shkurtesat për fjalët:

1. domethënë .....
2. e të tjera .....
3. Kombet e Bashkuara .....

2 pikë

B) Numrin shkruaje me shkronja.

515 .....

1 pikë

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!  
Thueja kangës sate që të vlon në gji.  
Nxirre gëzimin tand' të shpërthejë me vrull...  
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

Thueja kangës, rini, pash syt e tu...  
Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu  
me zjarrm tand, rini... Dhe të na mbysi dallga  
prej ndjenjash të shkumbzue me q'i turbullon kanga.

Rini, thueja kangës dhe qeshu si fëmi!  
Kumbi i zanit të përplaset për qiellë  
dhe të kthejë prap te na - se hyjt ta kanë zili

e na të duem fort si të duem një diell.  
Thueja kangës, Rini! Thueja kangës gëzimplotë!  
Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote.

**19.** Dallo gjininë letrare dhe llojin letrar të cilit i përket vjersha.

.....  
(gjinia letrare)

.....  
(lloji letrar)

2 pikë

**20.** Rretho numrin para ciklit të këngëve ku bën pjesë vjersha në fjalë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Kangët e Ringjalljes
2. Kangët e Rinisë
3. Kangët e Fundit

1 pikë

**21.** A) Lajtmotivi i poezisë është:

1. Thuaja këngës
2. Qeshu rini

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**B) Argumento përgjigjen nën A.**

.....  
.....  
.....

1 pikë

**22. Vjersha ngjan në:**

1. Tingëllimë
2. Vargje të lira
3. Vargje të bardha
4. Vargje të thyera
5. Vargje popullore

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**23. A) Nëse konstatimi është i saktë, rretho PO, dhe nëse nuk është, rretho JO.**

Në strofën e parë vihet re një thirrje për të treguar gjallërinë dhe forcën, si tharmin e kësaj poezie.

PO

JO

**B) Argumento përgjigjen nën A duke treguar dëshirën e poetit dhe detajet që e portretizojnë rininë dhe poetin.**

.....  
.....  
.....

2 pikë

**24. Si quhet rima që ka përdorur poeti në këtë poezi?**

.....

1 pikë

**25.** Mos përdridh duartë; rri urtë e ulu,  
Në qoftë se zakoni i mallkuar.

Se kam për të përdredhur zemrën tënde,  
O Hamlet, mos fol më;

A) Përshkruaje figurën stilistike e cila nuk i përket vargut të dhënë.

.....

1 pikë

B) Argumento përgjigjen nën A.

.....  
.....

2 pikë

**26.** Në bazë të emrit të personazhit shkruaj titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet.

Maria Kardana .....

Tanusha .....

Beatriçja .....

3 pikë

**27.** Rretho numrin para fjalës ku kemi ndryshimin e shpërngjashmimit dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. zbardh
2. skuq
3. taman

1 pikë

**28.** Gjeju funksionin sintaksor fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

Nga dheu i ujshëm dilte një avull që shkonte drejt nga qielli.

i ujshëm .....

një avull .....

2 pikë

**29.** A) Shkruaj foljen *kam pasë* në normën letrare.

*kam pasë* .....

1 pikë

**B) Përcakto mënyrën, kohën dhe formën e saj.**

mënyra .....

koha .....

forma .....

1 pikë

**30.** Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si një tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin.

Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).

Kij kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

**1. Votreni – Inteligjenca e së keqes (*Xha Gorio* – HONORE DË BALZAK)**

**Udhëzime për shkrimin e esesë:**

- Sqaroje rolin e Votrenit në roman (kryesor ose dytësor).
- Përshkruaje Votrenin (kush është ai, përse banon në pension, marrëdhëniet që ka me personazhet tjerë).
- Përshkruaje dimensionin moral të personazhit dhe shpjegoje motivimin e veprimeve të tij dhe dimensionin moral dhe motivimin e personazhit (ilustro me shembuj nga vepra).
- Në formë të përfundimit jepe përjetimin tënd të Votrenit dhe argumentoje atë (nëse ai është viktimë ose kriminel)

## 2. Lumturia është e bukur vetëm derisa e presim

### Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Thuhet se lumturia është në gjëra të vogla. Komentoje këtë fjali dhe jepe qëndrimin tënd për këtë.
- A varet lumturia nga ne apo nga njerëzit përreth nesh? Jepe dhe shpjegoje qëndrimin tënd.
- Çfarë është vendimtare për realizimin e lumturisë (shëndeti, paraja, dashuria... ose diçka tjetër)? Argumentoje përgjigjen.
- Komunikoj si e kupton ti vargun *Lumturia është e bukur vetëm derisa e presim*.

25 pikë



















1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				